

12.02.2021  
Ora 12:48

**RENDI I DITËS**


*Projektvendim “Për miratimin e modeleve të dokumenteve që do të përdoren nga grupi i numërimit dhe Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M.Logu), LSI (A.Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Atëherë fillojmë me shqyrtimin e çështjeve që kemi sot në rendin e ditës, në seancë publike. Pika e parë është projektvendimi “Për miratimin e modeleve të dokumenteve që do të përdoren nga grupi i numërimit dhe Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”. Kemi shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin si subjekt zgjedhor, të kandidatit për kryetar bashkie, për Bashkinë Durrës, të paraqitur nga Partia Lëvizja e Re, dhe pika e fundit, hedhja e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Mirë, fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me miratimin e modeleve.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

**Z. Y. Merkaç:** Presidenti i Republikës ka dekretuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë. Referuar përcaktimit të nenit 119 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se anëtarët e grupit të numërimit plotësojnë tabelën e rezultateve për çdo qendër votimi, sipas formularit tip të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kemi përgatitur tabelat e rezultateve, të cilat, tabelat e rezultateve për qendrat e votimit model ZAZ nr.30, tabelën e rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor, model KZAZ 32, model i vendimit të KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, model KZAZ 34-1, model i dokumentacionit, i cili do të printohet në letër A4 dhe bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe tabelat përmbledhëse të rezultateve, nr. model 30, 32 dhe 34/1, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po! Për ta përmbledhur mund të themi që nuk kemi ndonjë ndryshim krahasur me, thjesht përshtatje, krahasuar me zgjedhjet e 25 prillit. Thjesht kanë reflektuar ato ndryshime që lidhen me këto zgjedhje. Përfaqësuesit e partive, në parim? Dakord! Edhe me aktin, dakord! Mirë, miratojmë modelet sipas drafteve të propozuara.

**Vendimi nr. 71**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



12.02.2021  
Ora 12:49

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”  
për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, zoti Jonid Robert  
Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M.Logu), LSI (A.Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për regjistrim si subjekt zgjedhor, të kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, të prezantuar nga Partia Lëvizja e Re.

**Z. Y. Merkaj:** Partia Lëvizja e Re është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin e zotit Jonid Robert Nano, si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, si dhe dokumentacionin përkatës. Nga verifikimi zoti Jonid Nano ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit dhe nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se në rubrikën, të dhënat personale, pika “b”, ka deklaruar se ka ndryshuar mbiemrin nga Jani, Janiol, në Jonid. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

sonë vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka kthyer përgjigje, ku rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë. Pra, rezulton i padënuar. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Zgjedhor, si dhe në mbledhjen e datës 12.02.2022 ka verifikuar dokumentacionin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, të depozituar nga Partia Lëvizja e Re dhe ka konstatuar se nuk ka mungesa në dokumentacion, por ka pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, pasi subjekti zgjedhor Lëvizja e Re, nuk disponon mandatin në këshillin bashkiak dhe zonja Alneida Rroshi, nuk i përket subjektit politik Lëvizja e Re, por subjektit politik Partia Socialiste. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Pra, me pak fjalë nuk është se ka pasaktësi, por ka mungesë në dokumentacion, sepse mungon dokumentacioni mbështetës për kandidimin? Po!

**Znj. M. Koja:** Elementët dokumentarë janë të gjithë të plotësuar, nuk ka mangësi në dokumentacion, por përmbajtja e tyre nuk është në përputhje me Kodin Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Duke qenë se patëm mundësi, të themi, edhe dje të njihemi me dokumentacionin. Pra, një nga kërkesat kryesore për ato parti që nuk janë parti parlamentare është të sjellin në qoftë se është rasti, një vërtetim që zotërojnë, një mandat në njësinë vendore përkatëse, në rastin konkret në Këshillin Bashkiak të Durrësit, dhe rezulton që Partia Lëvizja e Re nuk disponon asnjë mandat në Këshillin Bashkiak të Durrësit. Nuk mjafton fakti që t'i bashkëlidhet një vërtetim që x ose y është anëtar. Kështu që për efekt të kërkesës ligjore është njësoj

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*


si këtë dokument mos ta kishim, për sa kohë po them, mënyra sesi është dokumenti. Pra thuhet, Këshilli Bashkiak i Durrësit, vërteton që zonja Eneida Rroshi është anëtare e këshillit bashkiak. Mund të vërtetonte dhe që x, y ose filan fisteku është po ashtu anëtar i këshillit bashkiak, por jo, nuk do të thotë në asnjë rast që ky anëtar i këshillit bashkiak i përket Partisë Lëvizja e Re. Edhe nga verifikimi që i bëmë tabelave finale, ose përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve të vitit 2019, nuk rezulton që Partia Lëvizja e Re, madje as të ketë marrë pjesë, por as të ketë fituar ndonjë mandat në Këshillin Bashkiak Durrës. Kështu që në këto kushte vlerësojmë se në përputhje, po them, edhe me kërkesat e nenit 67 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror duhet të vendosë mosregjistrimin e këtij kandidati, për shkak se nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar nga ligji dhe akti nënligjor.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Diskutime të tjera? Nuk kemi! Mirë, atëherë i përfundojmë këtu diskutimet. Atëherë, bazuar dhe në relatimin e bërë nga administrata dhe shqyrtimi i dokumentacionit që i është bashkëlidhur kërkesës për regjistrim, jemi në kushtet e mosregjistrimit të kandidatit për kryetar bashkie, të propozuar nga ky subjekt. Ndaj vendosim mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 72**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



12.02.2021  
Ora 12:54

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M.Logu), LSI (A.Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, që lidhet me hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022.

**Z. Y. Merkaj:** Pas kalimit të afatit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe depozitimit të listave të kandidatëve, renditja e subjektit zgjedhor në fletën e votimit për zgjedhjet për kryetar të datës 6 Mars 2022 bëhet me short. Procedura e shortit është si më poshtë. Kemi përgatitur shirita letre ku janë shënuar emrat e subjekteve zgjedhore, të cilat pasi të palosen do të futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe masë të njëjtë, të cilat do të futen në një enë transparente.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! A ka informacione nga KZAZ-ja Vorë dhe Rrogozhinë në qoftë se kanë proceduar me regjistrimin e kandidatëve?

**Z. I. Celibashi:** Po, i kemi të gjitha!

**Z. Y. Merkaj:** Ka ardhur përgjigjja.


**Z. I. Celibashi:** Ndoshta duhet ta kishim referuar këtë gjë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Se dje e kishim vetëm për Dibrën, prandaj po them.

**Z. I. Celibashi:** Po, i kemi të gjitha vendimet e regjistrimit! Po! Domethënë e kemi listën e kandidatëve të përfunduar, të cilët janë regjistruar për këto zgjedhje. Po mund të procedoni!

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pasi i kemi vendosur shiritat e letrës, në të cilat janë shkruar emrat e subjekteve zgjedhore, në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente, një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që në rastin konkret është Sara, do të tërheq goglën dhe do të nxjerrë emrin e subjektit zgjedhor, të cilit i lind e drejta të tërheq i pari tek goglat e shortit. Shorti do të hidhet sipas dekretit të Presidentit, siç e ka caktuar dekreti i Presidentit, për Bashkinë Shkodër. Për Bashkinë Shkodër janë 3 subjekte zgjedhore që garojnë. E para do të tërheqë Partia Socialiste tek gogla e dytë, e cila përmban shiritat që janë shënuar numri nga 1 – 3. Futen dhe këto në gogla me

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë, në një enë të dytë transparente. Atëherë do të vazhdojmë me tërheqjen e subjektit zgjedhor që të përcaktojmë se cili subjekt do të tërheqë i dyti. Pasi përzihen goglat, hapet gogla, nxirret shiriti i letrës, i cili lexon koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, i cili do të tërheq i dyti, tek ena transparente e dytë. Vazhdojmë me goglën e tretë. Është Partia Demokratike, e cila do të tërheqë e treta, tek ena transparente e dytë. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Duke qenë se nuk ka përfaqësues Partia Socialiste, vazhdon përfaqësuesi i KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të Partisë Socialiste. Dhe është numri 1, tek fleta e votimit për kryetar të Bashkisë Shkodër, do të jetë subjekti zgjedhor Partia Socialiste e para. Vazhdojmë me tërheqjen për koalicionin “Shtëpia e Lirisë”, përfaqësuesi i koalicionit do ta tërheqë vetë. Shiriti i letrës përmban nr. 2, tek fleta e votimit për Bashkinë Shkodër do të jetë subjekti zgjedhor koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i renditur i dyti në fletën e votimit. Vazhdojmë me goglën e tretë. Numri 3 do të jetë Partia Demokratike. E njëjta procedurë do të vazhdojë dhe për Bashkinë Dibër, e cila ka 4 subjekte zgjedhore, përveç 3 të parave dhe Lëvizja e Re. E njëjta procedurë, shiritat e letrës ku janë shënuar subjektet zgjedhore do të palosen dhe do të futen në 4 gogla, në enën e parë transparente. Mbarojmë njëherë procedurën e parashortit, do të trazohen goglat tek ena e parë transparente, do të tërhiqen nga përfaqësuesi i KQZ-së. nga gogla e parë, shiriti i letrës përmban emrin e Partisë Demokratike, së cilës i lind i drejta të tërheqë e para në enën transparente të dytë. Vazhdojmë me subjektet zgjedhore. Shiriti përmban emrin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, e cila do të tërheqë e dyta numrat në enën e dytë transparente. Vazhdojmë me goglën e tretë, Partia Socialiste do të tërheqë e treta. Partia Lëvizja e Re do të tërheqë e katërta, tek ena e dytë transparente. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Shiritat e letrës me numrin nga 1 - 4 palosen dhe futen tek goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë. Duke qenë se tek procedura e parashortit Partia Demokratike

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

është e para që i lind e drejta për të tërhequr goglat tek ena e dytë transparente, ftohet përfaqësuesi i PD-së të tërheqë goglat.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Autorizojmë punonjësin e KQZ-së ta bëjë.

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë është numri 2. Në fletën e votimit për kryetar të Bashkisë Dibër, do të jetë Partia Demokratike e renditur e dyta. Vazhdojmë me koalicionin “Shtëpia e Lirisë”. Ftohet përfaqësuesi i koalicionit, i cili e tërheq vetë. Atëherë është numri 1. Në fletën e votimit për Bashkinë Dibër do të jetë koalicioni “Shtëpia e Lirisë” e renditur e para. Vazhdojmë me Partinë Socialiste, duke qenë se nuk ka përfaqësues, tërhiqet nga përfaqësuesi i KQZ-së. dhe shiriti i letrës mban numrin 3. Partia Socialiste do të jetë e renditur e treta me fletën e votimit për Bashkinë Dibër. Dhe e katërta, shikojmë numrin katër! Do të jetë Partia Lëvizja e Re. Vazhdojmë të njëjtën procedurë me Bashkinë Durrës, e cila ka 3 subjekte zgjedhore. Palosen letrat, Partia Demokratike e para. Pasi janë palosur shiritat, e vendosur subjektet zgjedhore, përfaqësuesi i KQZ-së tërheq goglat tek ena e parë transparente dhe për Bashkinë Durrës do të jetë koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, i cili do të ketë të drejtën të tërheqë i pari tek ena e dytë transparente, për renditjen. Vazhdojmë me procedurën, Partia Socialiste do të jetë e dyta që do të tërheqë goglën, tek ena e dytë transparente dhe e treta është Partia Demokratike. Vazhdojmë procedurën e shortit. Shiritat e letrës me numrin nga 1-3 palosen dhe futen në gogla me peshë, formë dhe ngjyrë të njëjtë, në enën e dytë transparente. Ftohet përfaqësuesi i koalicionit të tërheqë goglat tek ena e dytë transparente, për caktimin e renditjes së subjekteve në fletën e votimit të Bashkisë Durrës. Dhe është numri 1. Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” do të jetë i renditur i pari tek fletët e votimit për Bashkinë Durrës. Vazhdojmë me Partinë Socialiste, duke qenë se nuk ka përfaqësues,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

autorizohet përfaqësuesi i KQZ-së dhe del nga goglat numri 2. Partia Socialiste do të jetë e renditur e dyta në fletën e votimit për Bashkinë Durrës. Dhe gogla e tretë me numrin 3, që do të thotë që është Partia Demokratike e renditur e treta në fletën e votimit për Bashkinë Durrës. Vazhdojmë të njëjtën procedurë për Bashkinë Vorë. Kemi 3 subjekte zgjedhore. Shiritat e letrës me emrat e subjekteve palosen dhe futen në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në enën e parë transparente. Përfaqësuesi i KQZ-së pasi përzien goglat, tërheq të parën. Është Partia Socialiste, së cilës i lind e drejta të tërheqë e para për renditjen në fletën e votimit. Vazhdojmë me goglën e dytë. Është koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, i cili ka të drejtën të tërheqë e dyta dhe Partia Demokratike do të tërheqë e treta goglën tek ena e dytë transparente. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Shiritat e letrës shënohen nga numri 1 – 3, futen tek goglat dhe hidhen në enën e dytë transparente. Duke qenë se tek parashorti Partia Socialiste ishte e para që do të tërheq, autorizohet përfaqësuesi i KQZ-së të tërheq goglën dhe është numri 2 tek fleta e votimit, për Bashkinë Vorë. Partia Socialiste do të renditet e dyta. Vazhdojmë me koalicionin “Shtëpia e Lirisë”. Ftohet përfaqësuesi i koalicionit. Është numri 1. Në Bashkinë Vorë tek fleta e votimit për Bashkinë Vorë, subjekti zgjedhor, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” do të jetë i pari. Vazhdojmë me hapjen e shiritit dhe është numri 3. Partia Demokratike do të jetë e treta, e renditur e treta në fletën e votimit për Bashkinë Vorë. Vazhdojmë të njëjtën procedurë për Bashkinë Rrogozhinë. Edhe këtu janë 3 subjekte zgjedhore. Shiritat e letrës me emrat e subjekteve zgjedhore futen në goglat me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë në enën e parë transparente, përzihen nga përfaqësuesi i KQZ-së, tërhiqet gogla. Partisë Socialiste të Shqipërisë i lind e drejta të tërheqë e para tek ena e dytë transparente për shortin. Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” do të tërheqë i dyti, dhe Partia Demokratike do të tërheqë e treta për Bashkinë Rrogozhinë. Vazhdojmë me procedurën e shortit. Shiritat e letrës me

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

numrin 1 – 3 futen në goglat dhe hidhen në enën e dytë transparente. Për Bashkinë Rrogozhinë, Partia Socialiste ka fituar e para që të tërheqë numrat për renditje. Përfaqësuesi i KQZ-së tërheqë numrin, dhe është numri 2. Për Bashkinë Rrogozhinë, Partia Socialiste do të renditet e dyta. Vazhdojmë me koalicionin “Shtëpia e Lirisë”, ftohet përfaqësuesi i koalicionit të tërheqë goglën. Është numri 3. Në fletën e votimit të Bashkisë Rrogozhinë, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” do të renditet i treti dhe Partia Demokratike do të renditet e para. Vazhdojmë të njëjtën procedurë për Bashkinë Lushnje. Edhe për këtë bashki janë 3 subjekte zgjedhore, ndërmjet të cilave do të hidhet shorti. Shiritat e letrës me emrat e subjekteve zgjedhore futen në goglat dhe hidhen në enën e parë transparente. Përfaqësuesi i KQZ-së pasi i përzien, tërheq njërën prej tyre. Është koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, i cili ka të drejtë të tërheqë i pari tek gogla e dytë transparente. Vazhdojmë me procedurën e parashortit. Partisë Demokratike i lind e drejta të tërheqë e dyta dhe Partia Socialiste është e treta për të tërhequr. Goglat vazhdojnë me procedurën e shortit. Shiritat e letrës nga 1 – 3 futen në goglat dhe vendosen në enën e dytë transparente. Nga rezultati i parashortit, koalicionit i lind e drejta të tërheqë i pari goglën, ftohet përfaqësuesi i koalicionit “Shtëpia e Lirisë”. Në shiritin e letrës lexohet numri 3. Në fletën e votimit për kryetar të Bashkisë Lushnje, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” do të renditet i treti. Partia Demokratike ka të drejtën të tërheqë e dyta. Është numri 2. Në fletën e votimit Bashkia Lushnje, Partia Demokratike do të renditet e dyta dhe numri 1, shfaqet tek shiriti i letrës, është Partia Socialiste, e cila do të renditet e para tek fleta e votimit, për zgjedhjet e Bashkisë Lushnje. Të bëjmë një përmbledhje?

**Z. I. Celibashi:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Nga rezultati i shortit, fletët e votimit si do të jenë të renditura: Për Bashkinë Shkodër, Partia Socialiste e para, koalicioni i dyti dhe Partia Demokratike e treta.

Për Bashkinë Dibër, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i pari, Partia Demokratike e dyta, Partia Socialiste e treta dhe Partia Lëvizja e Re e katërta.

Për Bashkinë Durrës, koalicioni do të renditet i pari, Partia Socialiste e dyta dhe Partia Demokratike e treta.

Për Bashkinë Vorë, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i pari, Partia Socialiste e dyta dhe Partia Demokratike do të renditet e treta

Për Bashkinë Rrogozhinë, në fletën e votimit të Bashkisë Rrogozhinë, Partia Demokratike është e para, Partia Socialiste do të renditet e dyta dhe koalicioni do të renditet i treti.

Për Bashkinë Lushnjë, në fletën e votimit do të renditet Partia Socialiste e para, Partia Demokratike e dyta dhe koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i treti.

Ky është rezultati i shortit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord me rezultatin e shortit! Mirë, e miratojmë rezultatin e shortit sikurse u relatua. Ne mundet ta miratojmë dhe përmbajtjen e fletës së votimit, se kjo ndoshta do t’u interesonte dhe gjithë subjekteve. Do të lëmë një seancë për sot mbasdite. Nëse keni nevojë për kohë, dakord mund ta shtyjme! Mund të lëmë dhe një orë më vonë mos t’ju okupojmë mbasditen? Mund ta përgatisim përmbajtjen? Shortin e hodhëm. Elementët janë të miratuar. Renditjen do ta pasqyrojmë në fletën e votimit.

**Z. Y. Merkaj:** Modeli, ngjyra, madhësia e letrës?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.02.2022*

**Z. I. Celibashi:** Po, pra të gjitha këto t'i miratojmë. Sot nëse mund ta bëjmë paradreke, po e bëjmë paradreke.

**Z. Y. Merkaj:** Në rregull! Për modelin nuk e di, duhet të flasim, ndoshta me ju, ndoshta me partitë, çfarë ngjyre do ketë?

**Z. I. Celibashi:** Patjetër! Dhe me partitë do flasim, edhe me mua do flasësh!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Siç ka qenë praktika në zgjedhjet e mëparshme. Thjesht ideja, ajo gjë të paktën, ne si subjekt na intereson që thjesht në fletën e votimit të ketë qartësi për votuesin. Pastaj elemente të tjera të natyrës teknike, besoj që administrata e KQZ-së ka gjithë *background*-in dhe eksperiencën.

**Z. I. Celibashi:** Ta lëmë pasdreke?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** E lëmë!

**Z. I. Celibashi:** Edhe ndërkohë ne përgatisim një ose dy variante të themi, ose një, dhe jua dërgojmë juve, nëse keni ndonjë opinion paraprak. Atëherë kështu po e lëmë. Në rregull sot në 17:30, mbledhja për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit! Faleminderit!

**Vendimi nr. 73**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

